

# Së bashku për Siguri



## Kryesuesi

Kryetari i komunës është kryesues i KKSB-së. Në bashkëpunim me policinë, ai/ajo së bashku me bashkëpunëtorët rekordon veprime dhe i udhëheq iniciativat drejt përmirësimit të sigurisë së bashkësisë.



## Përfaqësuesi i sektorit komunal të emergjencave civile

Kjo pozitë zakonisht bartet nga dikush me kualifikime akademike në menaxhim dhe planifikim të emergjencave. Ky rol ka të bëjë me mbrojtjen civile ndaj fatkeqësive natyrore, me sigurinë dhe parandalimin e zjarrit, analizat e rrezikut dhe rastet tjera të emergjencave ku ekziston kërcënimi ndaj jetës dhe pronës. Ky zyrtar komunal është aty për ta siguruar komunikimin dhe bashkërendimin ndër sektorial që janë elementet kyçë për trajtim të suksesshëm të situatave emergjente, përfshirë evakuimin dhe procedurat e reagimit.



## Komandanti i stacionit të policisë

E komandon dhe udhëzon shërbimin policor në bashkësinë tuaj në pajtim me ligjin për policinë dhe aktet e zbatueshme nënligjore. Mes tjerash, roli i komandantit është të stacionit policor përfshirë raportoj përkaitja me trendet e krimit dhe veprimet policore në të gjithë sektorët policor, duke e shtuar njëkohësisht komunikimin dhe bashkërendimin e policisë lokale me forumet e sigurisë në bashkësi dhe akterët tjere.



## Kryesuesi i komitetit për komunitete

Komiteti për komunitete i përbërt nga përfaqësues të kuvenit komunal dhe të bashkësive, angazhohet për proces pjesëmarrës të vendimmarries, që është përfshirë për të gjitha bashkësítë dhe pjesëtarët e tyre, duke i garantuar të drejtat e njeriut dhe ato civile të bashkësive etnike në komunë. Kryesuesi i komitetit për komunitete i sjell perspektivat e të gjitha bashkësive në vëmendje të policisë, profesionistëve dhe aktivistëve tjera të cilët mund të kontribuojnë në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të tyre në nivel komunal.



## Kryesuesi i këshillit të prindërve

Përfaqësuesi i nominuar nga këshillat e prindërve të themeluar në të gjitha institucionet arsimore dhe trajnuese në nivel lokal, ka mandat që t'i fuqizoj prindërit në adresimin e brengave të tyre të sigurisë drejtprësëdrejtë tek zyrtarët komunal dhe policor, me qëllim që të ndihmoj në përmirësimin e sigurisë së fëmijëve brenda mjediseve shkollore.



## Kryesuesi i KLSP-së

Komititet Lokale për Siguri në Publike (KLSP) janë themeluar në secilin sektor policor me qëllim të adresimit të nevojave të sigurisë së bashkësive lokale dhe më qëllim që edhe atyre t'iu jepet mundësia e nrgritjes së zërit në çështjet e punës policore në bashkësinë e tyre. KLSP-të i kanë përsynim kryesisht vendbanimet rurale përmes bashkëpunimit dhe zgjidhjes së problemeve si dhe janë mekanizma bazë të policimit në bashkësi, që shërbejnë për të korriguar çështjet dhe problemet e identifikuara përmes projekteve dhe planeve të veprimit në bashkëpunim me Policinë e Kosovës. Kryesuesi i secilës KLSP i raporton komandantit të stacionit dhe mban kontakte të rregullta me koordinatorin e KKSB-së.



## Përfaqësuesi i mediave lokale

Një gazetar lokal apo ekspert i mediave mund të nominohet nga kryetari i komunës për t'i përfaqësuar mediat lokale që janë aktive në komunë. Informimi i duhur dhe me kohë është jetik për angazhim civil dhe bashkëpunim të mirë në terren. Gazetarët dhe mediat mund ta shtojnë në masë të madhe njoftimin e populatës për zgjidhjen e çështjeve të sigurisë në bashkësi, për planet dhe projektet, derisa kontribuojnë në përmirësimin e bashkëpunimit në terren përmes lajmeve ditore dhe raportimeve për çështjet e sigurisë.



## Zyrtari për barazi gjinore

Zyrtarët komunal për barazi gjinore (ZKBGj) janë shërbyes civilë në nivel komunal të ngarkuar me punë përrarritjen e barazisë gjinore si dhe harmonizimin e çështjeve gjinore në politika komunale, legjislativën dhe praktikën. Sipas ligjit përkatës, ZKBGj-të kontribuojnë në promovimin, avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me theks të veçantë në barazinë gjinore.




## Drejtori i drejtorisë së arsimit

Drejtori i drejtorisë së arsimit merr përgjegjësinë e zhvillimit të arsimit dhe siguron përmirësimin të cilësisë së mësimit dhe nxënies nëpër shkolla, përfshirë formësimin e të ardhmes së banorëve së bashku me ministritë relevante. Disa nga përgjegjësitë përfshijnë monitorimin e procesit të arsimit, zhvillimin e rregulloreve të punës për shkollat dhe kodin e mirësjelljes për personelin e shkollave dhe studentët.



## Përfaqësuesi i shoqërisë civile

Shoqëria civile luan rol jetik në realizimin e ideve, politikave, programeve apo strategjive të reja për ndryshim social, në mbajtjen e zyrtarëve komunal përgjegjës për zotimet e tyre dhe identifikimin e problemeve si mungesa e burimeve apo vëmendjes nga niveli qendror. Organizatat e shoqërisë civile janë gardianët e personave të varfér dhe të ceneshëm, duke u siguruar që politikë-bërësit të mos i harrojnë ata. Si i tillë, kontributi i përfaqësuesit të tyre në këtë këshill konsultativ të sigurisë është i pamatshëm.



## Përfaqësuesi i bashkësisë fetare

Secila bashkësi fetare ka të drejtë që ta nominoj përfaqësuesin e saj në KKSB. Roli i këtij anëtarë është që të promovo dhe mbroj të drejtat dhe interesat e bashkësisë që e përfaqëson, të ndaj brengat dhe propozoj zgjidhje që kontribuojnë përmëdisë më të sigurt dhe më tolerant në komunë.



## Përfaqësuesi i bashkësisë etnike

Secila bashkësi etnike ka të drejtë që ta nominoj përfaqësuesin e saj në KKSB. Ky përfaqësues vepron në emër të interesave të tërë etnisë që banon në komunën përkatëse, me theks të veçantë në mbrojtjen e të drejtave kulturore, gjuhësore dhe të drejtave specifike të njeriut të pjesëtarëve të bashkësisë së tij/saj.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) është organ konsultativ që merret me çështje të sigurisë dhe përfshin përfaqësim të gjerë të komuniteteve dhe grupeve të interesit, me qëllim që të krijojnë mëdisë më të sigurt për të gjithë në bashkëpunim të ngushtë me policinë lokale. Anëtarët e KKSB-së tuaj diskutojnë për parandalimin e krimit, planet e sigurisë dhe përmirësimet e sigurisë në tërë territorin e komunës suaj, në secilin fshat dhe lagje. Kontaktoni TANI përfaqësuesit e KKSB-së tuaj dhe kontribuoni për lagje më të sigura dhe të ardhme më të sigurt përfshirë fëmijët tuaj. Ne mund të punojmë së bashku. **Së bashku për siguri!**